

## Pse qyteti i New York ka rifreskuar programin e HIV/AIDS?

Që nga 1987, në bazë të rregullave të departamentit të arsimit të shtetit të New Yorkut shkollat duhet të ofrojnë informacion mbi HIV/AIDS-in që nga kopshti deri në klasën e 12-të. Qyteti i New York ndërtoi programin e HIV/AIDS për nxënësit e shkollave publike në vitet 1990. Informacioni mbi kursin e HIV/AIDS-it, kurimin dhe parandalimin ka ndryshuar nga që kur u shkrua për herë të parë. Programi i rifreskuar që u botua në 2005-ës përmban informacion të ri dhe shkencërisht të saktë mjekësor. Për shembull ilace të reja kanë përmirësuar dhe zgjatur jetën e të njerëzve me HIV/AIDS. Gjithashtu përparime në mjekësi e kanë ulur numrin e rasteve të transmetimit të HIV-it gjatë shtatëzansë dhe lindjes. Por megjithë shpresën që sjellin këto avancime, HIV/AIDS vazhdon të jetë një rrezik i madh. Akoma nuk ekziston kura për infektimin me HIV. Nuk ka vaksinë për ta parandaluar. Jo çdo kush mund të përfitojë nga ilacet e reja. Edukimi për parandalimin e infeksionit është esencial.

### A janë vërtet të nevojshme këto mësimet?

PO. Sipas studimeve një numër i madh të rinjsh vazhdojnë të vënë veten në rrezik nga infeksioni i HIV me veprimet e tyre.

### Sa të përgatitur janë mësuesit mbi këto çështje të ndjeshme dhe të rëndësishme të shëndetit?

Një sërë programesh trajnimi për administratorët dhe mësuesit i kanë njohur ata me programin e rifreskuar, gjithashtu ata kanë në dispozicion dhe mbështetje të vazhdueshme teknike. Programet e trajnimit filluan në Tetor 2005 dhe do të vazhdojnë deri në pranverë.

## DISA ARSYE PSE KEMI NEVOJE PER NJE PROGRAM MBI HIV/AIDS-in NE SHKOLLAT PUBLIKE TE QYTETIT TE NEW YORK-UT.

Ne duhet të fillojmë me edukimin për parandalimin e HIV/AIDS herët për fëmijët dhe adoleshentët.

Qyteti i New York-ut është epiqendra për HIV/AIDS në Amerikë, me numrin më të lartë të rasteve AIDS-it në SHBA dhe numrin e dytë më të lartë për raste të reja të AIDS-it në vend pas District of Columbia. <sup>1, 2</sup>

Transmetimi heteroseksual përbën 33% të rasteve të reja të diagnostikuara në vitin 2004. <sup>2</sup>

Në vitin 2005, 48% e të tërë nxënësve të shkollave të mesme publike të NYC që moren pjesë në anketë raportuan që nuk kanë bërë ndonjëherë seks. <sup>3</sup>

18% e nxënësve të shkollave të mesme publike të NYC raportuan që kanë pasur 4 apo më shumë partnerë seksualë gjatë jetës së tyre. <sup>3</sup>

30% nxënësve të shkollave të mesme publike të NYC që janë aktivë seksualisht nuk kanë përdorur prezervativ herën e fundit që kanë bërë seks, duke vënë veten dhe/ose partnerët e tyre në rrezik për marrjen e HIV/AIDS, infeksioneve të tjera të përhapura me rrugë seksuale, dhe/apo shtatëzani të pa dëshiruar. <sup>3</sup>

Në vitin 2003, vajzat adoleshente përbënin gjysmën e të tërë rasteve të HIV të raportuara në SHBA të moshës 13-19 vjeç. <sup>4</sup>

Është llogaritur që deri në fund të vitit 2004, 529.113 persona me AIDS kanë vdekur në SHBA, përfshirë 15.798 në vitin 2004. <sup>2</sup>

<sup>1</sup>Raport i komisionit mbi HIV/AIDS të qytetit të New York-ut, 31 Tetor 2005;

<sup>2</sup>CDC, Raporti i mbikëqyrjes HIV/AIDS, Vol. 16, 2005;

<sup>3</sup>2005 Anketë mbi sjelljet e rrezikshme të rinisë NYC (YRBS), NYC Departamenti i Arsimit/Departamenti i Shëndetësisë dhe Higjienës Mendore, NYC;

<sup>4</sup>CDC, "Mbikëqyrja e HIV/AIDS tek adoleshentët" (gjatë 2003)



Departamenti i qytetit të New York-ut  
Joel I. Klein  
Kancelar

# EDUKIMI MBI HIV/AIDS

**Mosha e duhur**  
Për nxënësit në çdo klasë K-12

**E saktë nga ana mjekësore**  
Ndërtuar sëbashku me qytetin e New York-ut  
Departamenti i Shëndetësisë  
dhe Higjienës Mendore

**Sistem praktik**  
Ndërtuar me të dhëna nga  
prindërit dhe komuniteti

## Si i ndihmojnë mësimet nxënësit për të qenë të shëndetshëm?

Programi i rifreskuar i HIV/AIDS paraqet mësimet të përshtatshme për moshën dhe zhvillimin e nxënësve për t'i ndihmuar fëmijët dhe adoleshentët të kuptojnë natyrën e HIV/AIDS, metodat e transmetimit, metodat e parandalimit, dhe mënyra për të ndihmuar shokët apo të afërm të cilët mund të kenë HIV/AIDS. Mësimet përdorin strategji që përforcojnë rëndësinë e komunikimit me prindërit/kujdestarët, mësuesit dhe me adultët e duhur. Aktivitete interaktive përforcojnë aftësi si planifikimi dhe përcaktimi i synimeve, komunikimi, influencimi dhe marrja e vendimeve, dhe caktimi i kufijve. Për një edukim shëndetësor sa më të plotë, nxënësit do të mësojnë jo vetëm mbi HIV-in por edhe se si mbahet trupi i shëndetshëm apo si sëmuremi.

## Si prind, si mund të mësoj më shumë mbi mësimet e fëmijës tim në shkollë?

Prindërit dhe kujdestarët inkurajohen të shqyrojnë programin në internet në adresën [www.nycenet.edu/HealthEd](http://www.nycenet.edu/HealthEd) apo të merrni një kopje në shkollën e fëmijës tuaj. Gjithashtu mund të kontrolloni orarin se kur do të ketë seanca informacioni për prindërit në shkollën tuaj. Drejtori dhe pjestarë të tjerë të stafit do të flasin se si mësuesit do të zhvillojnë mësimet. Si me çdo temë mësimi mbi shëndetin, është e rëndësishme që prindërit e kuptojnë se ç'farë po mësojnë fëmijët e tyre në shkollë dhe mbështesin fëmijët e tyre që të jenë dhe të qëndrojnë të shëndetshëm.

Drejtorët kanë për detyrë që të paktën pesë mësimet mbi HIV/AIDS në vit të zhvillohen nga kopshti deri në klasën e 6, dhe gjashtë mësimet nga klasa e 7 deri në klasën e 12.

## Kush më siguron që ky program është i përshtatshëm për fëmijën tim?

Një nga pikat më të rëndësishme për rifreskimin e programit është që të sigurohemi që çdo mësim të jetë i përshtatshëm për moshën. Fëmijët kanë nevojë për informacion të saktë mjekësor të prezantuar në një mënyrë dhe kohë të përshtatshme me nivelin e tyre të zhvillimit. Gjatë gjithë programit abstemini theksohet si mënyra më e përshtatshme dhe më efektive për parandalimin e transmetimit të HIV-it dhe sëmundjeve të tjera.

### SHEMBUJ SE Ç'FARE MESOJNE NXENESIT NË SHKOILËN FILLORE

**Klasat K-3** Bazat e parandalimit të sëmundjeve: larja e duarve, mbulimi i gojës kur teshtin apo kollitësh dhe pastrimi dhe lidhja e lëndimeve. Fëmijët mësojnë të mos prein gjakur e njerëzeve të tjerë, dhe të kërkojnë ndihmën e adultëve kur dikush ka gjakderdhje. Ata mësojnë se HIV-i është një virus që transmetohet me anë të gjakut që dëmton sistemin e imunitetit. Ata gjithashtu mësojnë për të qenë dashamirës ndaj fëmijëve dhe adultëve që janë të sëmurë me HIV/AIDS.

**Klasat 4-5** Mësimet përqendrohen mbi funksionin e sistemit të imunitetit dhe se si transmetohet HIV-i. Aktivitetet përqendrohen se si t'i rezistohet shtyrjes negative të shoqërisë dhe "të zgjidhet një shoqëri me të njëjtat besime, vlera dhe interesa." Nxënësit mësohen që të mos përdorin alkool dhe drogë dhe kurrë të mos përdorin të njëjtën shiringë apo objekte të tjera të mprehta që mund të transmetojnë gjak nga një person tek tjetri. Abstenimi nga seksi theksohet.

## Përse këto mësimet flasin për sjellje dhe aftësi për të cilat nxënësit kanë nevojë?

Njohja e nxënësve me informata të sakta mjeksore dhe të përshtatshme për moshën mbi HIV/AIDS është vetëm një pjesë e asaj që nxënësit duhet të mësojnë. Mësimet kultivojnë përgjegjësi dhe dashamirësi. Ato i ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë aftësitë për të marrë vendimet e duhura në çdo aspekt të jetës së tyre. Për shembull, nxënësit mësojnë si t'i rrezikojnë shtyrjes negative të shoqërisë dhe të evitojnë sjellje të rrezikshme.

## Por në qoftë se prindi/kujdestari është i shqetësuar?

Koordinatorët me prindërit kanë një kopje të programit të rifreskuar mbi HIV/AIDS, dhe ne ju ftojmë ta shqyrtoni dhe t'i tregoni pyetjet apo shqetësimet tuaja stafit të shkollës. Ju lutemi vini re se të tërë nxënësit janë të detyruar nga rregullat e shtetit të New York-ut të marrin pjesë në mësimet mbi natyrën e HIV/AIDS dhe metodat e transmetimit të HIV-it. Prindërit kanë të drejtën për t'i nxjerrë fëmijët nga mësimet individuale mbi metodat e parandalimit. Ne besojmë se këto mësimet janë mbrojtëse dhe të përshtatshme për moshën, por në qoftë se ju preferoni t'i nxirrni fëmijët tuaj, ju duhet t'i dërgoni një letër drejtorit të fëmijës ku të kërkonin nxjerrjen e fëmijës suaj nga klasa gjatë mësimet mbi parandalimin. Letra jauaj duhet të thotë se ju do ta mësoni vetë fëmijën mbi parandalimin. Në qoftë se dëshironi mund të kërkonin materiale të programit për ta bërë këtë gjë.